

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-113/14

Prishtinë, 19 Shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

Z. J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) nr. KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA33138) të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 19 Shkurt 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z. J.;
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 i datës 5 shtator 2012, për sa i përket kërkesës nr. KPA33138

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 19 mars 2007 Z. (S.) J. (në tekstin e mëtejme: Pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon ri-posedimin e ngastrën nr.224, Zona Kadastrale Qarakoc, Komuna e Kamenicës, që ndodhet në Qarakoc, me sipërfaqe prej 5 ari e 21 m² (në tekstin e mëtejme: Prona). Ai ka theksuar se ai e ka humbur posedimin mbi pronën për shkak të konfliktit të armatosur në vitet 1998/99 ku përmend datën 7 nëntor 2000 si datën e humbjes. Ai thekson se tani ajo është e uzurpuar ilegalisht.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij Pala ankuese ka dorëzuar *inter alia* dokumentet vijues:
 - Fletën Poseduese nr. 231 të datës 19 shkurt 2007, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Kamenicës.
3. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin e lëndës KPA33138.
4. Kërkesa për pronën është njoftuar më 13 nëntor 2007 dhe me 31 gusht 2010.
5. Asnjë person i interesuar nuk ishte paraqitur në AKP si Palë përgjegjëse në kërkesë.
6. Më 5 shtator 2012, me vendimin KPCC/D/A/164/2012, KKPK vendosi të hedhë poshtë kërkesën me arsyetimin(paragrafët 12 dhe 90) se kërkesa është shqyrtuar më herët dhe për të është vendosur përmes një vendimi të plotfuqishëm administrativ ose gjyqësor.
7. Vendimi i është dorëzuar Palës ankuese të premtën më 31 janar 2014.
8. Të hënën, më 3 mars 2014, Pala ankuese ka dorëzuar një ankesë në Gjykatën Supreme ku ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së.
9. Sipas dosjes së lëndës, KKPK në vendimin e saj i është referuar vendimit mbi kërkesën KPA33482. Me kërkesë të Gjykatës Supreme AKP i ka dërguar Gjykatës Supreme një kopje të vendimit grupor të KKPK-së, KPCC/D/A/972010 të datës 7 dhjetor 2010, dhe vendimin e vërtetuar të nxjerr nga vendimi Grupor për sa i takon kërkesës KPA33482.
10. Më 23 dhjetor 2014 një urdhër gjykate, i datës 9 dhjetor 2014, i dorëzohet Palës ankuese. Ky urdhër gjykate shkruan:

'1. Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së i referohet një tjetër 'vendimi administrativ ose gjyqësor'. Këtu është fjala për vendimin e KKPK-së nr. KPCC/D/A/97/2010 të datës 7 dhjetor 2010 lidhur me kërkesën nr. KPA33482 që ka të bëjë me ngastrën nr. 224 në Qarakoc, me sipërfaqe prej 5 ari, 21m². Me këtë vendim miratohet kërkesa e Paraqitësit të kërkesës, Z. S. J., si pronar i pronës së kërkuar. AKP i ka siguruar Gjykatës Supreme kopjen e këtij vendimi. Kopja e këtij vendimi mund të gjendet e bashkangjitur me këtë urdhër. Sipas informacionit në ueb-faqen e AKP-së vendimi është zbatuar me datën 20 qershor 2012.

Nga Pala ankuese kërkohet të deklaroj nëse ky informacion është arsyeja për ndryshimin e bazës së ankesës në

kuptimin se ajo mund të jetë arsye për tërheqjen e ankesës.

2. Nëse Pala ankuese qëndron pas ankesës ai kërkohet ta dëshmoj, të ketë prova, pse, duke marrë parasysh këtë informacion lidhur me vendimin e KKPK-së nr. KPCC/D/A/97/2010 për sa i takon kërkesës nr. KPA33482, vendimi i kundërshtuar KPCC/D/A/164/2012 për sa i takon KPA33138 nuk mund të qëndroj.

Pala ankuese udhëzohet të përgjigjet brenda tre javësh nga marrja e këtij urdhri. Në rast të mos-përgjigjes ndaj këtij urdhri kjo mund të qoj në një aktgjykim nga Gjykata Supreme, bazuar në informacionin dhe provat në dispozicion, pa marrë më tej palën në pyetje.

11. Pala ankuese nuk është përgjigjur ndaj këtij urdhri të gjykatës.

Pretendimet e Palës ankuese

12. Pala ankuese thirret në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Në ankesën e tij ai ka theksuar se ai është pronar i pronës së kërkuar siç evidentohet në Fletën Poseduese nr.231 dhe se nuk ekziston asnjë vendim administrativ apo gjyqësor lidhur me kërkesën e tij për ngastrën nr. 224. Ai kërkoi të dorëzoi kopjen e vendimit të cekur të KKPK-së. Prandaj, ai kërkoi nga Gjykata Supreme të miratoj ankesën e tij dhe të marr një vendim tjetër duke e vërtetuar të drejtën e tij pronësore mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës 30 ditore siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Ndonëse dita e 30-të nga dita e dorëzimit të vendimit të KPPK-së Palës ankuese të premtën më 31 janar 2014 është e diel 2 mars 2014, periudha për të paraqitur ankesë është shtyrë deri të hënë me 3 mars 2014 (shih nenin 7.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut që e zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 në Aneksin 1 me atë ligj i cili thotë: “Nëse fundi i periudhës do të binte të shtunën, të dielën apo në ndonjë festë zyrtare, periudha në fjalë shtyhet deri në fund të ditës së parë vijuese të punës”, dhe Ligji mbi Procedurën Kontestimore, neni 126, paragrafi 5 i cili

parasheh: “Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore, të shtunën apo të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.”

Meritat

14. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave nga dosja e lëndës, vendimit të kundërshtuar dhe pretendimeve të Palës ankuese, Gjykata Supreme konstaton se ankesa duhet të refuzohet.
15. Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së i referohet një tjetër vendimi administrativ ose gjyqësor. Vendimi në fjalë është ai nr. KPCC/D/A/97/2010 i datës 7 dhjetor 2010 lidhur me kërkesën nr. KPA33482 lidhur me të njëjtën pronë. Në atë vendimin tjetër kërkesa i miratohet Paraqitësit (të njëjtë) të kërkesës, Z. S. J., si pronar i pronës.
16. Pala ankuese nuk është përgjigjur në Urdhrin e Gjykatës që ceket më lartë në paragrafin 10 dhe nuk e ka kundërshtuar ekzistencën e këtij vendimit tjetër të KKPK-së.
17. Parimi i “*Res judicata*” parashihet me seksionin 11, paragrafi 4.c) të Rregullores se UNMIK-ut mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079(këtu e me tej: Rregullore e UNMIK 2006/50). Ky nen parasheh: “*Komisioni e refuzon kërkesën kur kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë*”. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i kundërshtuar i KPPK-së ka qenë i drejtë kur ka refuzuar kërkesën si “*Res Judicata*”. Kjo është situata në rastin aktual sepse e njëjta kërkesë është paraqitur para AKP-së dhe pala pjesëmarrëse ishte e njëjtë në të dy procedurat. Gjithashtu, faktet, baza ligjore si dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të dy kërkesat e paraqitura në KKPK.
18. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Rregullores se UNMIK 2006/50 dhe nenin 166, paragrafi 2, të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

19. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores se UNMIK 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjqtar

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it